

Shëndeti dhe siguria në punë – Obligimet sipas ligjeve WHS (“work health and safety”-Shëndeti dhe siguria ne punë)

Modeli i ligjeve për shëndetin dhe sigurinë në punë kërkon që punëdhënësit të kujdesen për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e njerëzve në vendin e punës. Kjo përfshin:

- sigurimin dhe mbajtjen e ambientit të punës të parrezikshëm për shëndetin dhe sigurinë
- sigurimin e hapësirave adekuate dhe të qasshme për mirëqenien e punëtorëve për të kryer punën e tyre, dhe
- monitorimin e shëndetit të punëtorëve dhe kushteve të vendit të punës për të parandaluar sëmundje apo lëndim.

Obligimi ndaj punëtorëve

Ju keni obligim të siguronit shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve tuaj. Ju duhet të eliminoni rrezikun ndaj ekspozimit në COVID-19, ose nëse kjo nuk është e mundshme, ju duhet të minimizoni rrezikun sa më shumë që është e mundur.

Mbroni punëtorët nga rreziku i ekspozimit në COVID-19 duke, për shembull:

- zbatuar punë me aranzhime nga shtëpia
- kërkuar nga punëtorët të praktikojnë distancën fizike dhe higjienën e mirë
- kërkuar nga punëtorët të qëndrojnë në shtëpi kur janë të sëmurë, dhe
- pastruar rregullisht dhe tërësisht vendin e punës.

Obligimet ndaj njerëzve tjerë në vendin e punës

Ju duhet të sigurohuni që puna në biznesin tuaj nuk i vë në rrezik shëndetin dhe sigurinë e njerëzve tjerë siç janë klientët dhe vizitorët.

Mbroni të tjerët nga rreziku i ekspozimit në COVID-19 by, për shembull, duke kërkuar nga ata që:

- të praktikojnë distancim fizik, përfshirë dërgimet dhe pagesat pa kontakt
- praktikojnë higjienë të mirë, dhe
- të qëndrojnë larg nga vendi i punës, përveç nëse është esenciale

Obligimi për të mirëmbajtur vendin e punës dhe hapësirat

Ju duhet të mirëmbani vendin tuaj të punës për t'u siguruar që ambient i punës nuk i vë në rrezik punëtorët dhe të tjerët të marrin COVID-19.

Mirëmbajnë ambient të sigurt të punës duke, për shembull:

- pastruar rregullisht dhe tërësisht vendin e punës
- ndrruar renditjen e vendit të punës për të mundësuar distancim fizik, dhe
- limituar numrin e njerëzve në vendin e punës.

Gjithashtu duhet të siguroni hapësira adekuate në vendin e punës duke përfshirë:

- hapësira për larjen e duarve me sapun, ujë dhe peshqir letreje
- sanitizues të duarve, aty ku nuk është e mundshme që punëtorët të lajnë duart e tyre, dhe
- dhomat e personelit të jenë të pastra dhe që mundësojnë distancim fizik.

Siguroni punëtorëve pauza të rregullta për të përdorur hapësirat, në veçanti për të larë duart e tyre.

Obligimi për të siguruar informacione, udhëzime dhe mbikëqyrje

Ju duhet t'i siguroni punëtorët tuaj me informacione apo trajnim që është i nevojshëm për të mbrojtur ata nga rreziku i ekspozimit në COVID-19 nga puna e tyre.

Kjo mund të përfshin:

- udhëzim se si të lahen duart në mënyrë të duhur
- trajnim se si të përshtasin dhe përdorin mjete personale mbrojtëse
- trajnim se si dhe kur të pastrojnë
- udhëzime se si të bëjnë një vend pune të sigurt të tyre, dhe
- udhëzime për qëndrimin në shtëpi nëse janë të sëmurë.

Obligimi për t'u konsultuar

Ju duhet t'i konsultoni punëtorët tuaj për çështjet në lidhje me shëndetin dhe sigurinë që kanë të bëjnë me COVID-19 dhe t'u jepet mundësia punëtorëve për të shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet. Merrni parasysh pikëpamjet dhe këshilloni punëtorët për rezultatin konsultativ.

Konsultohuni me punëtorët kur:

- bëni një vlerësim të riskut
- merrni vendime për masat kontrolluese për menaxhimin e risqeve, siç është prezentimi i punës sipas aranzhimeve nga shtëpia, apo restriktimin e vendit të punës për të siguruar distancim fizik
- merrni vendime në lidhje me hapësirat e vendit të punës, dhe
- propozoni ndryshime tjera që mund të ndikojnë në shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.

Ju duhet t'i ndjekni procedurat e pajtuara konsultative. Nëse ka përfaqësues të shëndetit dhe sigurisë, ju duhet t'i përfshini ata në konsultim.

Më shumë informacione

Për më shumë informacione në lidhje me COVID-19 dhe për shëndetin dhe sigurinë në punë, vizitoni uebfaqen [Safe Work Australia website](#).